



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

TIRANË

Tiranë, më 14.12.2021

NJOFTIM

**PËR FILLIMIN E PROÇEDURËS SË KONKURIMIT
PËR**

EMERIMIN NË POZICIONIN E PUNËS NJË VEND

Specialist –IT

Bazuar në Ligjin Nr 97/2016 “ Për Organizimin dhe funksionimi e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë , si dhe mbi bazën e “ Strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, me qëllim plotësimin e vendit vakant në zbatim të strukturës së Institucionit, në përmbushje të organikës Nr. 21 datë 29.01.2020 e në vazhdim, të Prokurorit të Përgjithshëm për Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë,

1. Kërkohet të punësohet 1 (një)punonjës/e me emertese Specialist -IT, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së shkallës së Parë Tiranë, me adrese Rr. “ Haxhi.H. Dalli” Nr 97 Tiranë..

N J O F T O N

1.Fillimin e Proçedurës së konkurimit të hapur të kandidateve për një pozicion me emertese Specilaist -IT, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë .

2. Referuar neneve 74,75,76 të Ligjit nr 97/2016 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë “, kandidatet e interesuar për konkurim, përveç kushteve të përgjithshme për tu pranuar në punë, duhet të plotesojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta.

-Konkurimi për vendin e punës në pozicionin “Specialis IT” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë , do të bazohet në:

-Njohurite mbi sistemet kompjuterike dhe pajisjet hardëare

- Njohuritë në lidhje me sitemet e operimit dhe funksionimin e rrjeteve LAN dhe WAN
- Njohuritë mbi operimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve ëeb based
- Njohuritë lidhur me sigurinë e sistemeve dhe rrjeteve
- Njohuritë për serverat , LINUX/Windows
- Njohuritë mbi rrjetet private (VPN)
- Njohuritë mbi instalimet, konfigurimin dhe riparimin e pajisjeve hardëare
- Njohuritë bazë të gjuhës angleze
- Të ruajë sekretin hetimor.
- Të njohë Ligjin “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.
- Të ketë aftësi komunikuese dhe pune në grup.
- Të njohë ligjin “Për Prokurorinë”.
- Të njohë Rregulloren e Institucionit
- Të njohë Kodin e Punës dhe atë të Proçedurave Administrative .

Kërkesat e Përgjithshme:

- Të jetë shtetas Shqiptar
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

Kërkesat e veçanta që janë prioritet në përzgjedhjen e kandidatëve :

- Diploma e nivelit “Bachelor” në Informatikë, Inxhinieri Informatike, Shkenca Kompjuterike, Inxhinieri Elektronike, Teknologji Informacioni, Informatikë ekonomike e noterizuar .
- Të zotërojë diplomë mastër në degët si më sipëre noterizuar
- Të ketë njohuri të Gjuhës Angleze
- Të ketë jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup

Pozicioni “specialist IT” ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore , por jo vetëm:

- “ Instalim, konfigurim të pajisjeve fundore dhe ato të rrjetit në Rrjetin AN të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
- Inspekton rrjetin fizik , sistemin dhe aplikimet për të identifikuar dhe zgjidhur keqfunksionimin apo vështirësitë e tjera në funksionim
- Mirëmbajtje në eficensë dhe në gjendje funksionale të pajisjeve fundore

- Asistence teknike për probleme që dalin gjatë punës në përdoruesit fundorë, formatim kompjuteërash, instalim, konfigurim programesh pune që janë të nevojshme për përdoruesit apo teknike që mund të lindin në kompjutera dhe pajisje të tjera fundore, nxjerrjen ruajtje të statistikave ndër vit etj.
- Kryen detyra të tjera të caktuara me ligj, akte nënligjore ose urdhër të eprorëve”

Dokumentacioni , mënyra dhe afati i dorëzimit

Në datën dhe orën e caktuar sipas njoftimit të shpallur nëpërmjet faqes zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme dhe njoftimit në ambjentet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë personat e interesuar duhet të paraqesin dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë për punësim,
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së Lartë, master, çertifikatë notash dhe çdo diplomë apo dokument tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar.
- e) Dëshmi penaliteti.
- f) Vertetim nga Gjykata
- g) Vërtetim nga Zyra e Përmbartimit Gjyqësor
- h) Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.
- i) Vërtetim njësisë administrative.
- j) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore
- k) Referenca ose vlerësim nga punëdhënësi të mëparshëm apo eprori direkt i pozicionit të fundit.
- l). Vertetim se ndja tij të mos jetë marrë masë disiplinore në marrëdhënie punë dhe /ose ndonjë masë tjetër disiplinore
- m) Vertetim nga Prokuroria që nuk ndiqet penalisht

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Vlerësimi i jetëshkrimit (CV) e kandidatit, që konsiston në arsimimin, kualifikimet dhe trajnimet e lidhura me fushën, përvoja lidhur me pozicionin e punës, vjetërsia , 20 pikë

Vlerësimi me shkrim 60 pikë

Për intervistën e strukturuar me gojë , 20 pike.

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët do të bëhet nëpërmjet adresave të email, me mesazhe në numrin e celularit të kandidatit, si dhe në faqen e internetit www.pp.gov.al dhe njoftimit në ambjentet e shpalljeve, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kandidatit, të paraqitet nga dt. 14.12.2021 ora 8.00 deri në datë 30.12.2021 ora 16.00, në K/sekretarinë e Prokurorisë Pranë gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Rr “ Haxhi.H. Dalliu “ Nr 97 Tiranë .

Verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidatet, e cila realizohet nga Kancelari i kësaj Prokurorie me qëllim vlerësimin e dokumentacionit nëse janë plotësuar kriteret e shpallura në njoftim.

Kandidatët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Testimi dhe Intervista me secilin kandidat, do të kryhet në ambjentet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, salla e mbledhjeve kati 6

Njoftimi i datës dhe ores së intervistimit për kandidatët e kualifikuar do të bëhet me telefon ose email nga Kancelari.

Testimi do të bazohet në kërkesat mbi kriteret e veçanta dhe njohuritë mbi ligjet e specifikuara në të.

Që kandidatët të shpallen fitues duhet të marrin mbi 70 pikë.

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TIRANË**